



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e dytë 2022

Oda e Mjekëve të Kosovës



Tetor 2022

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e dytë 2022	1
1. Infrastruktura Juridike.....	3
2. Këshilli Drejtues	3
3. Anëtarësimi	6
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	7
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	8
6. Licencimet	8
7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.....	9
8. Këshilli Mbikëqyrës.....	9
9. Komisioni për çështje Etike i OMK-së.....	9
10. Komisioni për Edukim Specialistik	10
11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	10
12. Raporti financiar	10
12.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 qershor 2022	10
12.2 Përkrashje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional.....	11
12.3 Prokurimi	11
13 Aktivitete të tjera.....	12
13.1 Botimi i Revistës Mjeku.....	12
13.2 Kongresi i tretë i Mjekësisë me temë Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat... 13	
13.3 Kongresi i IV-të i Mjekësisë- Diabeti Melit- Qasje interdisiplinare.....	13
13.4 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve - trajnimeve për stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit.....	14
13.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	15
14 Plani i veprimit për vitin 2022	15

1. Infrastruktura Juridike

Gjatë periudhës prill – qershor 2022, u mbajtë një (1) mbledhje nga kuvendi i OMK-së.

Me datë 23 qershor 2022 u mbajt mbledhja e III-të (3) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u bë plotësim-ndryshimi i rregulloreve si në vijim:

- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Punës të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Komisionit të Antaresimit, Licencimit dhe Rilicencimit;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes Etike;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për Procedurat e Prokurimit në OMK-ë;

Gjithashtu u marrën disa vendime si në vijim:

- Vendim për miratimin e amandamenteve për plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative të OMK-së;
- Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit për paga dhe mëditje;
- Vendim për aprovimin e rekomandimit të Këshillit Mbikqyrës për rritjen e pagave të Shërbimit Profesional të OMK-së.

2. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore prill – qershor 2022, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në 2 raste kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill - qershor	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	20	13	0	<ol style="list-style-type: none"> 1- Vendim për emërimin e këshillit organizativ të Kongresit të Diabetit 2- Vendim për aprovimin e ndryshimit të rregullores së Komisionit për Licencim, Këshillit Mbikqyrës, Procedura të prokurimit, Rregullorja për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike, Menaxhimi i financave, Edukimi i Vazhdueshëm Profesional, në Kuvendin e OMK-se 3- Vendim për rekrutimin e një zyrtari-e administrativ-e 4- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për inventar për zyre 5- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit të negociuar për vendin e mbajtjes së Kongresit të III-të 6- Vendim - Miratohet Raporti i punës i OMK-së për periudhën kohore tetor-dhjetor 2021 (TM4) 7- Vendim - Miratohet Raporti i Punës i OMK-së për vitin kalendarik 2021 8- Vendim - Aprovohet Raporti i auditimit funksional dhe financiar i OMK-së për vitin 2021 9- Vendim për Emërimin e Këshillit Shkencor për 	0

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill - qershor	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprahe
				<p>Kongresin vjetor me temën Diabeti</p> <p>10- Vendim Aprovohet Rregullorja për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe Zbatimin e Trajnimeve për Stafin e Shërbimit Profesional të OMK-së</p> <p>11- Vendim Aprovohet plotësim-ndryshimi i rregullorës së brendshme për pushimet e nënpunësve të shërbimit profesional të OMK-së</p> <p>12- Vendim Emërohet Dr Drita Mekuli Kryetare Nderi në Këshillin Shkencor të Kongresit vjetor me temën Diabeti</p> <p>13- Vendim për fillimin e procedurave të prokuimit për tenderin për material shpenzues për zyrë</p> <p>14- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për tenderin për inventar për zyrë</p> <p>15- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit të negocuar për material shpenzues për kongresin e III-të</p> <p>16- Vendim për ndarjen e dekoratës Nderi i Mjekut për Prof.Dr. Salih Ahmeti.</p> <p>17- Vendim për emërimin e Këshillit Organizativ për Kongresin e dytë Klinik bashkë-organizim me Kolegjin e Kirurgëve</p>	

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill - qershor	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprahe
				18- Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit të tenderit të negociuar për vendin e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit 19- Vendim për publikimin e njoftimit për pozitën e lirë Zyrtar-e për IT	

3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore prill – qershor 2022, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 150 mjekë, nga të cilët janë 6 mjekë të punësuar në sektorin publik, 23 mjekë të punësuar në sektorin privat, 119 mjekë të papunë dhe 2 mjekë në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën kohore prill - qershor 2022




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 qershor 2022

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 2 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 12 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 qershor është 5046 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM 2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	14	23	///	///	16	12
Këshilli Etik	8	7	Rekomandime kolegjale 3 (50.00€) Qortim Publik 1 (50.00€) Gjoha:0 Gjithesëj : 200.00€	Qortim publik 1 (50.00€) Rekomandime kolegjale 3 (50.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithesëj: 200.00€	7	7

Gjyqi i Nderit	2	2	///	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	59	///	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejt, Gjyqi i Nderit ka mbajtur një (1) takim për periudhën raportuese T2.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës prill - qershor 2022 ka akredituar 39 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, katër shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, dy nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare kurse dy kërkesa janë aprovuar nga Komisioni.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës prill - qershor 2022, ka lëshuar 626 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka kërkuar auditim të procesit pasi që ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

8. Këshilli Mbikëqyrës

Gjatë periudhës prill-qershor 2022 Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues të OMK-së dhe të organeve të tjera të OMK-së.

9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore prill - qershor 2022, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe shqyrtuar njëzetënëntë (29) kërkesa për leje për hulumtim.

Njëzetetë (28) kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim, ndërsa një (1) kërkesë komisioni e ka refuzuar.

10. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore prill - qershor 2022, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur tre (3) takime. Përgjatë këtyre takimeve komisioni ka punuar rreth plotësim-ndryshimit të draft rregullorës për Edukim Specialistik.

11. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore prill - qershor 2022, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar tre (3) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë tre (3) vendime pas aprovimit të kërkesave të parashtruara nga palët.

12. Raporti financiar**12.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 qershor 2022**

1.0 Të hyrat:			
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2021	€	611,305.00	
Total të hyrat e shtyera nga 2021			€611,305
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	269,310	€
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	3,050	€
1.1.4 Licencimi	€	34,825	€
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€	10,806	€
1.1.6 Donacione për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€	1,000	N/A
1.1.7 Projekti i LuxDEV	€	84,000	N/A
Të hyrat deri me 30.06.2022	€	402,991	€
		139,182	€
			€
Të hyrat e shtyera nga 2021			€
			611,305
TOTAL TË HYRAT			€
			1,153,478

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€	64,278	€
2.2 Material shpenzues	€	830	€
2.3 Reprerentacioni	€	585	€
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	2,920	€
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	6,700	€
2.6 Shpenzimet e asetëve			€
			600
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritetet	€	1,620	€
			3,266
			€
			4,886

2.8 Xhirollogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€	53,856	N/A	€	53,856	
2.9 Llogari të pagueshme	€	5,366	€	3,103	€	8,469
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2022	€	136,155	€	98,558	€	234,713

TOTAL BILANCI

€ 918,765.71

1.1.5*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.5*Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel.,Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit,Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

2.7*Tek përkrahja për solidaritet përveq mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasoje e infektimit me virusin COVID19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

2.8* Në raportin financiar për periudhën derimë 31 dhjetor 2021, janë të përfshira edhe mjetet e menaxhuara nga OMK, të cilat janë në kuadër të projektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, për ndërtimin e obeliskut “Për Jetën” kushtuar veprës dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor ndër dekada. Qëllimi i këtij njoftimi është se mjetet e bartur nuk janë pasuri e Odës së Mjekëve, por janë mjete të projektit i cili vazhdon edhe në vitin 2022.

12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës prill - qershor 2022 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Shoqatën e Anesteziologëve dhe Intensivistëve të Kosovës për organizimin e “Seminarit Kombëtar”, me vlerë 210 €.
- Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës për organizimin e Java e Puntorive “Intervenimet Laparoskopike-Endoskopike në 4 lëmi Kirurgjike dhe Ultratingulli” me vlerë 3,067.00 €.

12.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore prill - qershor 2022 u zhvilluan katër procedura të hapura të prokurimit, tre procedura të negociuar të prokurimit dhe një procedurë e prokurimit me vlera të vogla:

Gjatë periudhës prill-qershor u zhvilluan 2 procedura të hapura të prokurimit për furnizim me material shpenzues për zyret e OMK-së. Pas ftesave të bëra për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për furnizimin me material shpenzues për zyret e OMK-së, këto procedura të tenderit janë anuluar për shkak të mungesës së ofertave të pranuar. Procedura e tenderit për furnizimin me material shpenzues për zyret e OMK-së do të rishpallet.

Poashtu në këtë periudhë u zhvilluan 2 procedura të hapura të prokurimit për furnizim me inventar për nevojat e zyrës të OMK-së. Pas ftesave të bëra për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për furnizim me inventar për nevojat e zyrës të OMK-së, njëra procedurë e tenderit është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të pranuar, ndërsa pas rishpalljes kjo procedurë e tenderimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në muajin maj u zhvillua me sukses procedura me vlera të vogla për ndërtimin e stendave për panairin e Kongresit të III-të të Mjekësisë, Pandemia COVID-19 – Sfidat dhe Përvojat.

Në muajin maj u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit për përzgjedhjen e vendit të mbajtjes së Kongresit të III-të të Mjekësisë Pandemia COVID-19 – Sfidat dhe Përvojat. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në muajin maj poashtu u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit për furnizimin e OMK-së me material shpenzues për nevojat e organizimit të Kongresit të III-të të Mjekësisë Pandemia COVID-19 – Sfidat dhe Përvojat. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në muajin qershor u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit për përzgjedhjen e vendit të mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të OMK-së. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

13 Aktivitete të tjera

13.1 Botimi i Revistës Mjeku

Gjatë periudhës Prill-Qershor u publikua Revista Mjeku- Sëmundjet Kardiovaskulare.

Ne muajin Qershor u bë publikimi i Revistës me temën bosht “Sëmundjet Kardiovaskulare”. Revista përmban 21 artikuj, të përmbledhura në 57 faqe. Artikujt prezantojnë fushën e Kardiologjisë në përgjithsi dhe në veçanti sëmundjet kardiovaskulare, aktualitetet në OMK dhe disa artikuj relevant dhe cilësor.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës ([REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë më të gjerë.

13.2 Kongresi i tretë i Mjekësisë me temë Pandemia COVID-19, Sfidat dhe Përvojat

Me datë 02 qershor u bë hapja solemne e Kongresit të tretë të mjekësisë – Pandemia Covid19 – Sfidat dhe Përvojat, ku të pranishëm ishin Ministri i Shëndetësisë, Prof.Dr. Rifat Latifi, kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu, Këshilltari politik i zyrës së Kryeministrit, Z. Jusuf Ulaj, Kryetar i Këshillit Shkencor, Prof.Dr. Salih Ahmeti si dhe përfaqësues të ndryshëm të institucioneve relevante në Republikën e Kosovës dhe ligjërues të huaj e vendor.

Në ceremoninë e hapjes solemne të Kongresit të III-të të Mjekësisë u nda edhe dekorata nderi i mjekut “Ali Sokoli” për Prof. Dr. Salih Ahmeti si dhe u ndanë çmimet për 10 punimet më të mira shkencore, për vitin 2021.

Me datë 03 dhe 04 qershor u zhvilluan punimet e Kongresit në sesione sipas këtyre temave:

- Shëndeti Publik dhe Menaxhimi i Pandemisë COVID-19;
- Menaxhimi Ambulantor dhe Klinik i COVID-19;
- Shëndeti Mendor dhe COVID-19;
- Të tjera.

Kongresi i Tretë i Mjekësisë “Pandemia COVID-19 – Sfidat dhe Përvojat” ka përfunduar me sukses. Në dy ditët e këtij Kongresi kanë marrë pjesë rreth 2500 doktor të mjekësisë, specialistë të fushave të ndryshme. Ata patën rastin të ndjekin punimet shkencore nga ligjërues vendor dhe të huaj.

13.3 Kongresi i IV-të i Mjekësisë- Diabeti Melit- Qasje interdisiplinare

Me datë 18-19 Nëntor 2022 pritet të mbahet Kongresi i IV Mjekësor, me rreth 2000 pjesëmarrës.

Pritet të ftohen ligjërues të huaj që do të marrin pjesë në këtë Kongres, në mënyrë që të shpalosin përvojën e tyre në fushën e Diabetit Melit-Qasja interdisiplinare. Këshilli Organizativ dhe Këshilli Shkencor veç se kanë filluar angazhimet e tyre, ku edhe me këtë rast kanë caktuar afatet për pjesëmarrje, për dorëzimin e abstrakteve dhe për sponzor.

Në kuadër të këtij Kongresi do të jenë edhe punëtori të ndryshme ku pjesëmarrësit do të kenë mundësi të ndjekin ligjeratat për tema më specifike.

13.4 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve - trajnimeve për stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti Lux Dev kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve.

Me datë 25 mars u nënshkruan Marrëveshjet për financim të trajnimeve mes OMK-së dhe Spitaleve të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, ku më pas dhe u publikua thirrja publike për trajner për mbajtjen e trajnimeve për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Organizimi i trajnimeve do të filloj gjatë muajit Shtator/Tetor, ku ne pjesën e parë do të mbulohen trajnimet në fushat si në vijim:

- Kursi për Dopplerin e enëve të gjakut
- Kursi për Echo transezofageale
- Kursi Ultratingulli i trurit (tek fëmijët)
- Kursi për EEG
- Kursi për funksionin e gjëndrës tiroide
- Kursi për Ultrasonografinë abdominale
- Ultratingulli i artikulationit coxofemoral tek neonatët

Trajnimet priten t'u ofrojnë mjekëve aftësi për të ofruar shërbime të specializuara për pacientët dhe t'u mundësojë atyre që të njihen mirë dhe të jenë kompetentë në kuptimin, funksionimin dhe aplikimin e pajisjeve ekzistuese në punën e tyre të përditshme brenda departamenteve të tyre spitalore përkatëse. Trajnimet duhet të rrisin shkathtësitë e stafit të përzgjedhur për të punuar në departamente të specializuara, si dhe do të mundësojn për të mësuar më shumë rreth cilësisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

13.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësive profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën prill-qershor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	1	1	0	3	0

14 Plani i veprimit për vitin 2022

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të IV multidisiplinar me fokus diabetin